

VENDIM
Nr. 501, datë 30.7.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 965, DATË 25.10.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E FINANCIVE DHE MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, TË PRONËS ME NR. 37, ME EMËRTIMIN "MINISTRIA E MBROJTJES", ME VENDNDODHJE NË BULEVARDIN "DËSHMORËT E KOMBIT", TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shkronjën "b", të pikës 1, të vendimit nr. 965, datë 25.10.2013, të Këshillit të Ministrave, të shtohet shkronja "b/1", me këtë përmbajtje:

"b/1) Nga sipërfaqja e përgjithshme, kaluar në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, objekti me sipërfaqe 673 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre) m², pjesë e pronës me nr. 37, me vendndodhje në bulevardin "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, të kalojë në përgjegjësi administrimi të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sipas planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi, për t'u përdorur si mjedise pune nga ky institucion."

2. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLANVENDOSJA E PRONËS NR. 37

Sipërfaqja e objektit që kërkohet për kalim kapital nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS) Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)



